

PROCESVERBAL
nga seanca e 39-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 17.10.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:
Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë përmes lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm edhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional përmes lidhjes video-konferencë:
mr.Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr.Emilija Janevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Arben Saiti, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanoska.

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski hapi seancën e 39-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:15 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 38-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 09.10.2024.
2. Propozim-vendim për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor, në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës me Propozim - Dokumentacion Konkursi dhe Propozim - Aplikim.
3. Propozim-vendim për refuzimin e kërkesës me shkrim të palës së interesuar për marrjen e vendimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në zonën e komunës së Tetovës.
4. Propozim-rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sponsorizim.
5. Propozim për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë për shkelje të nenit 51 paragrafi 1 të LSHMAAV.

6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit Total TV për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Vëndosja dhe zbatimi i standardit ISO 27001:2013 - sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit.
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe me 5 vota "pro" dhe një abstenim nga z. Petrushevski miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 38-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 09.10.2024, mbajtur më 30.09.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr.Magdalena Davidovska Dovleva shpjegoi Propozim-vendimin për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor, në nivel lokal, në zonën e Kumanovës së Kumanovës me Propozim - Dokumentacion Konkursi dhe Propozim - Aplikim. Shpjegoi se Studimi për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit për radio në Kumanovë ka treguar se ka arsytet. Kumanova është komunë me më shumë banorë në Maqedoni, ka edhe potencial të konsiderueshëm ekonomik, gjegjësisht me numër të konsiderueshëm të subjekteve afariste aktive. Subjekte afariste aktive më shumë ka vetëm në Manastir dhe Tetovë. Nga ana tjetër, në Kumanovë vetëm dy radiostacione kanë leje për transmetim në zonën lokale, nga ku njëra, pjesën me fjalë e transmeton në gjuhën maqedone dhe serbisht, ndërsa tjetra në shqip. Duke pasur parasysh performancën e tyre ekonomike, me dhënien e një leje të re, nuk do të rrezikohet cilësia e ofertës ekzistuese programore, përkundrazi, do të pasurohet, publiku do të marrë përmbajtje të reja të karakterit lokal dhe informacione për ngjarjet në kuadër të komunës. Propozimi është shpallja e konkursit për dhënien e lejes për shërbimin programor Radio folëse-muzikore me format të përgjithshëm, në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara kryejnë së paku dy nga tre funksionet mediatike dhe atë në gjuhën maqedonase.

Z. Fidanovski tha se në periudhën paraprake ka pasur një tendencë jo të këndshme të mbylljes së radiostacioneve për arsye të ndryshme. Tani ai tha se është i kënaqur me faktin që javët e fundit Këshilli ka marrë Vendime që duhet të shpallë konkurs publik për marrjen e lejeve të radios në nivel lokal. Kjo do të thotë se ka justifikim për një gjë të tillë dhe se ka subjekte të interesuara që dëshirojnë të hapin radio dhe që do të rrisë konkurrencën në nivel lokal dhe do të pasurojë peizazhin mediatik. Për këto arsye ai deklaroi se do ta mbështeste me kënaqësi propozimin.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim për shpallje të konkursit publik për dhënien e 1 (një) leje për transmetim në radio në nivel lokal, në zonën e komunës së Kumanovës, për shërbim programor radio-folëse-muzikore me format të përgjithshëm në të cilin llojet e programeve të përfaqësuara realizojnë së paku dy nga tri funksionet mediatike, në gjuhën

maqedonase, që do të transmetohen përmes radiofrekuencës së përcaktuar nga Agjencia për Komunikim Elektronik (AKE), përkatësisht: 92,6 MHz.

Leja do të jepet për një periudhë 9 (nëntë) vjeçare dhe nuk mund t'i transferohet personi tjetër.

Sektorii për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendim e mësipërm ta publikon në "Gazetën Zyrtare të RMV-së", në ueb-faqen e Agjencisë, dhe në dy gazeta ditore, prej të cilave njëra është në gjuhën e bashkësisë joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarët të RMV-së, dhe hyn në fuqi nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të RMV-së".

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për planifik strategjik dhe të drejtat e autorit mr.Magdalena Davidovska Dovleva, shpjegoi Propozim-vendimin për refuzimin e kërkesës me shkrim të palës së interesuar për marrjen e vendimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në zonën e komunës së Tetovës. Ajo shpjegoi se Tetova është komunë maqedonase me numrin më të madh të radiostacioneve. Ka pesë radiostacione dhe asnjë komunë tjetër nuk ka numër të tillë. Njëra prej tyre është radio folëse-muzikore ndërsa 4 janë radio muzikore-folëse. Në Kërkesë, parashtruesi kërkon radio muzikore dhe duke shpallur konkurs publik për dhënien e një leje të njëjtë me ato ekzistueset, vetëm do të dyfishohej oferta dhe kështu në asnjë mënyrë nuk do të sigurohej diversitetet. Për këtë arsye, pasi nuk ka arsyetim, propozohet që të refuzohet Kërkesa për shpallje të konkursit publik për radio muzikore në komunën e Tetovës.

Z. Ajdini tha se nga Studimi është konstatuar se nuk ka mundësi për një radio tjetër, sepse në Tetovë tashmë janë pesë radio, gjegjësisht në këtë moment nuk ka nevojë për radio të re që do të transmetojë program si radiot e tjera që transmetohet në atë komunë. Këtu është një situatë krejtësisht e kundërt sepse për Kumanovën kishte nevojë për një radio të tillë. Ai shpjegoi se dy herë ishte takuar me personin fizik që ka paraqitur kërkesën dhe ishte i gatshëm të bënte radio të mirë, por me formatin që ekziston. Ai tha se i vinte keq që nuk mund t'i ndihmoi kërkuarit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin refuzoi Kërkesën me shkrim të palës së interesuar, me plotësim (ark.nr. 08-697/6, datë 17.07.2024), për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor në nivel lokal në zonën e komunës së Tetovës, për arsye se me Studimin për përcaktimin e arsytimit për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio në nivel lokal në zonën e komunës së Tetovës (ark. nr.03-4243/1 datë 14.10.2024), është konstatuar se nuk ka arsyetim për shpallje të konkursit publik për dhënien e lejes për radio muzikore në nivel lokal, në zonën e komunës së Tetovës.

Sektorii për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 4

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore mr. Emilija Janevska shpjegoi Propozim-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sponsorizim. Ajo shpjegoi me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe

Audiovizuele nga korriku i vitit të kaluar, janë bërë ndryshime në rregullat për sponsorizim, në vetë dispozitën, por edhe në përkufizimin e termit sponsorizim. Për këto arsye është dashur që të fillohet procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores. Këshilli i Agjencisë, në seancën e 29-të mbajtur më 17 korrik 2024, miratoi Draft-rregullore për të cilën hapi (seancë) debat publik në kohëzgjatje prej 45 ditësh dhe përfundoi më 2 shtator. Gjatë diskutimit publik është pranuar vetëm një propozim për tekstin e Draft dokumentit, nga udhëheqësi i Radio Kanalit 77, z. Viktor Gavrilov, i cili ka kërkuar nga Agjencia që të bëjë ndryshim në nenin 8 paragrafi 2 të Rregullores, gjegjësisht të lejojë më shumë mënyra për etiketimin e sponsorizimit, përveç përdorimit të fjalës "sponsor". Propozimi u pranua dhe u inkorporua në Propozim-rregulloren, ndërsa ndryshime të tjera nuk janë bërë. Formulimi i mëparshëm në Rregullore në nenin 8 paragrafi 2, ishte se sponsori duhet të identifikohet qartë duke përdorur fjalën "sponsor". Tani është shtuar, "ose duke përdorur shprehje të tjera të përshtatshme" dhe janë vendosur në kllapa disa nga shprehjet që janë përmendur në shkresën e Kanal 77, "mbështetur nga", "në bashkëpunim me", "mundësuar nga", "në partneritet" dhe të tjera. Ajo shpjegoi se ndryshime të tjera, në lidhje me Draft tekstin e miratuar më parë nga Këshilli nuk ka. Duke marrë parasysh sa më sipër, propozohet që Këshilli të miratojë Propozim-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për Sponsorizim, i cili më pas do të botohet në Gazetën Zyrtare dhe më pas si Tekst i pastruar, do të publikohet në ueb-faqen dhe do t'u dorëzohet subjekteve, pra ofruesve të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sponsorizimin, me tekstin e propozuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për sponsorizimin ta publikon në "Gazetën Zyrtare të RMV-së" dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë tekst të pastruar.

Akt nënligjor i mësipërm (teksti i pastruar) t'u dorëzohet transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve video me kërkesë.

Pika 5

Udhëheqësja Janevska shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për kundërvajtje kundër SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë për shkelje të nenit 51 paragrafi 1 të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se nga mbikëqyrja është konstatuar se transmetuesi nuk ka vepruar sipas Aktvendimit për shqiptimin e masës vërejtje publike, gjegjësisht se nuk e ka mënjanuar shkeljen. Nga mbikëqyrja e kontrollit është konstatuar se TV GURRA nuk ka ofruar informacionin që duhet të vihet në dispozicion përdoruesve, si emrin e plotë të ofruesit të shërbimit mediatik audiovizual, adresën e selisë, të dhënat e kontaktit, për personi përgjegjës dhe për organin rregullativ kompetent. Për këto arsye, në pajtim me nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, propozohet që Këshilli i Agjencisë të miratojë Propozim për iniciimin e procedurës kundërvajtëse. Ajo vuri në dukje se pasi është dhënë Raporti i mbikëqyrjes në materialet për seancën, Spektori ka konstatuar se ka gabim teknik, ku shkruhet se televizioni transmeton program në nivel shtetëror, por duhet të jetë - në nivel lokal. Njoftoi se përpara se të fillojë procedura ligjore, Raporti do të korrigjohet.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit administrativ nr.10-4218/1 datë 10.10.2024 të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV GURRA SHPKNJP Kërçovë dhe ka konstatuar shkelje të nenit 51 paragrafi 1 të LSHMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi që kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV GURRA SHPKNJP Kërçovë të inicojë procedurë kundërvajtëse para gjykatës kompetente sepse me mbikëqyrjen e kontrollit administrativ mbi shërbimin programor transmetuar më 6 tetor 2024 është konstatuar se transmetuesi nuk ka vepruar sipas Akvendimit për shqiptimin e masës-vërejtje publike, gjegjësisht nuk e ka mënjanuar shkeljen e nenit 51 paragrafi 1 të LSHMAAV dhe nuk ka ofruar informacion që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve.

Spektori për çështje juridike duhet të përgatisë Kërkesë për iniciimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente për transmetuesin në fjalë.

Pika 6

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit TV Total për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV. Ai shpjegoi se në pajtim me gjetjet nga Raporti për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, ky operator ritransmeton disa kanale që nuk mbulohen me çertifikatën e regjistrimit. Duke qenë se këtë shkelje e bën për herë të parë këtë vit, propozohet që t'i shqiptohet masë vërejtje publike, si dhe të urdhërohet që menjëherë të mbyllë shërbimet programore të huaja që i ritransmeton pa çertifikatë regjistrimi. Gjithashtu proceduralisht ai informoi Këshillin se rreth një muaj më parë është bërë monitorim mbi Total TV dhe është konstatuar se ka kryer ritransmetim të të gjitha shërbimeve programore të shërbimit publik radiodifuziv.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-4226/1 datë 14.10.2024 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në pajtim me pikën 8 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, urdhërohet menjëherë pas pranimin të Aktvendimit për vërejtje publike të harmonizojë punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja është konstatuar se Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, e cila sipas njoftimit të AKE mund të ushtrijë veprimtari në territorin e RMV-së, me datë 14.10.2024 për përdoruesit e tij ka ritransmetuar shërbimin programor "Sky News", "Brazzers", "Reality Kings", "CNN", dhe "Narodna", të cilat nuk mbulohen me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV.

Spektori për çështje juridike të përgatisë Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit në fjalë.

Spektori për planifikim strategjik dhe të drejtën e autorit pas skadimit të afatit të përcaktuar në Akvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik Cvetanka Mitrevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik: Vendorsja dhe zbatimi i standardit ISO 27001:2013 - sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ajo shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim publik që është paraparë në Planin vjetor për furnizim publik të Agjencisë për vitin 2024, kurse mjetet janë të parapara në Planin Financiar të Agjencisë për vitin 2024. Sipas shumës së mjeteve që janë paraparë për këtë furnizim, do të realizohet si furnizim me vlerë të ulët, në pajtim me të gjitha dispozitat e Ligjit për furnizim publik për atë lloj procedure, që do të thotë se procedura do të fillojë me publikimin e njoftimit në sistemin elektronik për furnizim publik. Ajo shpjegoi se në materialet nën pikë ka edhe shpjegim se ky furnizim po kryhet me qëllim që Agjencia të çertifikohet me çertifikatë për menaxhim të sigurisë së informacionit. Mirëpo, për të siguruar këtë, duhet së pari të kryhet analiza dhe përgatitja e procedurave përkatëse, gjegjësisht, duhet të bëhet vendorsja dhe implementimi i këtij standardi, prandaj edhe propozohet të zbatohet.

Z. Petrushevski tha se nëse ky projekt apo furnizimi realizohet me sukses, Agjencia do të jetë ndër kompanitë e rralla në Maqedoni që e kanë këtë standard ISO. Përdoret kryesisht nga IT dhe kompani të forta. Për këtë arsye ai deklaroi se do të mbështeste propozimin për zbatimin e këtij furnizimi.

Z. Trajçev tha se si gjithmonë në raste të tilla dhe të ngjashme jep një sugjerim në pjesën e kriterëve çmim-cilësi. Ai tha se Këshilli në pajtim me Ligjin nuk ka kompetenca dhe nuk merr pjesë në mënyrën se si do të realizohet procedura. Këshilli jep vetëm miratimin e mjeteve dhe miratimin për fillimin e procedurës. Sidoqoftë, ekziston gjithmonë një parim kundër kriterit çmim-cilësisë që të jetë 50-50, domethënë, kudo që është e mundur, të shmanget kjo metodë. Ai beson se mund me kriterë të tjera të furnizimit të përcaktohet se kush mund të marrë pjesë, ndërsa çmimi më i ulët duhet të jetë ai që vendos se kush do ta marrë atë furnizim. Ai theksoi se ky është vetëm tregues i tij dhe nuk ka kompetencë për më shumë se kaq.

Udhëheqësja Mitrevska shpjegoi se bëhet fjalë për furnizim me vlerë të ulët, i cili sipas Ligjit për furnizim publik në lidhje me mundësitë mund të kërkohet vetëm formulari DRD. Aftësi të tjera nuk mund të kërkohen siç janë aftësi teknike dhe profesionale dhe gjithë të tjerat të parashikuara në Ligjin për furnizim publik. Për ato arsye, përmes kriterit të dhënies së kontratës për furnizim publik, në këtë rast raporti më i mirë i çmimit dhe cilësisë, është tentuar të merret një ofertë më e mirë për këtë furnizim publik.

Z. Petrushevski shpjegoi se kjo është vërejtje parimore e z.Trajçev, është e drejtë e tij dhe gjithmonë e thotë. Pëndryshe, Këshilli deri më tani nuk ka pasur mosmarrëveshje sa i përket miratimit të furnizimit publik.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Vendorsja dhe zbatimi i standardit ISO 27001:2013 - Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Vendorsja dhe zbatimi i standardit ISO 27001:2013 - Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, ndërsa mjetet sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**